

Qerim LITA

VRASJET E USHTARËVE SHQIPTARË NË ARMATËN E JUGOSLLAVISË NGA GJYSMA E DYTË E SHEKULLIT XX

Dhuna, terrori dhe gjenocidi policor jugosllav ndaj popullsisë shqiptare, që filloi menjëherë pas Rezolutës së Informbyrosë (korrik 1948),¹ u shtri edhe brenda Armatës jugosllave, në kuadër të së cilës vepronte Shërbimi Kundërzbulues, që njihej me shkurtesën “KOS” (Kontra-Obaveštajna Služba). Ky shërbim famëkeq, vrau qindra ushtarë të pafajshëm shqiptarë, arrestoi mijëra të tjerë, ndërkohë ndaj dhjetëra mijëra të tjerë zbatoi masa të rrepta represive, si: përndjekje, dhunë, torturë etj. Studiuesi shqiptar nga Kosova, Qazim H. Berisha, në veprën e tij “Ushtarë shqiptarë të vrarë në Armatën jugosllave”, thekson se brenda periudhës kohore 1951-1993, nëpër kazermat ushtarake jugosllave janë vra më shumë se 135 ushtarë shqiptarë dhe dhjetëra shqiptarë tjerë civilë.²

Tërë kjo fushatë e egër zbatohet në emër të “zbulimit të veprimtarisë armiqësore nga pozitat e nacionalizmit, irredentizmit”, përkatësisht “separatizmit”, në radhët e ushtarëve dhe eprorëve shqiptarë. “...Në Kosovë dhe përreth Kosovës, thuhej në një Analizë të KOS-it, vazhdon veprimtaria subversive nga forcat e ndryshme reaksionare të cilat si qëllim parësor kanë komprometimin e LKJ-së, forcat e armatosura dhe sistemin shoqëroro-politik në përgjithësi. Në mënyrë intensive, vazhdon veprimtaria e nacionalistëve dhe separatistëve shqiptarë të cilët kanë filluar gjithnjë e më shumë të përdorin metoda të ashpra të veprimit - përveç propagandës subversive, ata avokojnë dhe përgatisin veprime sabotuese-terroriste...”.³

¹ Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974, Përmbledhje dokumentesh, vëllimi 1, përzgjedhjen, redaktimin, përkthimin, parathënien dhe hyrjen: Qerim Lita, Logos-A, Shkup, 2018, dok. nr. 71, f. 339-350, Raport i ekipit të KQ të PKM-së, për ta studiuar gjendjen politike e ekonomike në rrethet kufitare, midis RFPJ-së, RP të Shqipërisë dhe RP të Bullgarisë, menjëherë pas Rezolutës së Informbyrosë, Shkup, 13 mars, 1949.

² Qazim H. Berisha, *Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën jugosllave (1951-1993)*, Mitrovicë, 2021, f. 26-29.

³ Arhiv Slovenije, F. Centralni Komite Zveze Komunistov Slovenije (në vazhdim AS.1.1589) teh-eno 1469, Komitet Organizacije SKJ u JNA, Vojna Tajna - Strogo

E ashtuquajtura “Armata Popullore e Jugosllavisë”, përbënte pjesën më antidemokratike të shoqërisë së atëhershme jugosllave, për arsye se ajo udhëhiqej nga një numër shumë i madh i eprorëve serbë, malazias e maqedonas me orientim prorus, përkatësisht stalinist⁴. Shtypi i atëhershëm demokratik jugosllav, në radhë të parë ai slloven e kroat, si; “Mlladina”, “Dello”, “Danas” etj., tek APJ-ja shihnin një “krijesë mbinacionale”, e cila paraqiste pengesë në “arritjen e barazisë kombëtare”. Përveçse e kontestonin “karakterin e përgjithshëm jugosllav”, ata në mënyrë të hapur shkruanin për politikën e saj antisllovene, antikroate e antishqiptare, dhe njëkohësisht mbrojtëse e politikës serbo-madhe në Kosovë. Nisur nga kjo, kërkohej ridefinimi i rolit shoqëror të APJ-së, përkatësisht, ndërprerjen dhe zëvendësimin e saj me “ushtri republikane e krahinore.⁵ Në kuadër të këtyre pikëpamjeve, më larg shkoi revista sllovene “Nova Revija”, e cila në vitin 1987 botoi “Programin kombëtar slloven”, ku ndër të tjera në të thuhej: *“...Nuk ka asnjë arsye ushtarake-strategjike që do të kërkonte që sllovenët shërbimin ushtarak ta kryenin në mjedis dhe nën komandë të huaj, në gjuhë të huaj, siç kjo është praktikuar në kohën kur ata nuk kanë qenë të pavarur, si dhe arsyet që në territorin e tyre të qëndrojnë njësi ushtarake të huaja të cilat nuk e kuptojnë komandën në gjuhën sllovene...”*.⁶

Sipas analizës me titull: “Nacionalizmi në shoqërinë jugosllave sot dhe reflektimi i tij në Armatën Popullore të Jugosllavisë”, të hartuar në janar të vitit 1989 nga KOS-i, rrezikshmërinë më të madhe për ekzistimin në shoqërinë jugosllave e paraqiste “nacionalizmi dhe separatizmi” shqiptar. *“...Në parim, theksonte Analiza, të gjithë nacionalizmat janë njëloj agresivë dhe të rrezikshëm për stabilitetin dhe perspektivën e Jugosllavisë... Mirëpo, meqenëse disa forma të nacionalizmit, në rrethana të caktuara mund të përhapen më shumë se nga format tjera të nacionalizmit, madje edhe deri në përmasat e kundërrevolucionit (nacionalizmi shqiptar), është e qartë se në rrethana konkrete ndonjë formë e nacionalizmit realisht mund të*

Poverljivo, Bezbednost i samozaštita u JNA i zadaci komunista i organizacije SK, Beograd, januara 1988 godine.

⁴ AS.1589.teh-eno-1467, Predsedništvo CK SKJ, 02-SZ-15/1, Za internu upotrebu, Ocene i stavovi Predsedništva CK SKJ o idejno-političkoj suštini i karakter napada na koncepciju ONO i JNA i zadacima Saveza komunista, Beograd, april 1988.

⁵ AS.1589.teh-eno 1469, Vojna Tajna - Poverljivo, Nacionalizam u Jugoslovenskom društvu i njegove refleksije u Jugoslovenskoj Nardnoj Armiji, Beograd, januara 1989 godine.

⁶ AS.1.1589, teh-eno 1469, Komitet Organizacije SKJ u JNA, Vojna Tajna - Strogo Poverljivo.

imponohet si më e rrezikshme se format tjera...”.⁷ Më tej, analiza ndalej në zbulimin e grupeve ilegale brenda APJ-së, nga viti 1948 e deri në vitin 1988, ku në mënyrë të qartë thuhej, se: “...përderisa pas vitit 1948, grupi i parë ilegal në APJ, është zbuluar në vitin 1976, ndërkohë, nga viti 1981 e deri në vitin 1988 janë zbuluar gjithsej 243 grupe ilegale nacionaliste në të cilat kanë qenë të përfshirë gjithsej 1 627 pjesëtarë të APJ-së të kombësisë shqiptare...”.

Zbulimi i këtyre grupeve sipas viteve ishte si vijon: në vitin 1981 - 60 grupe; në vitin 1982 - 70 grupe; në vitin 1983 - 35 grupe; në vitin 1984 - 41 grupe; në vitin 1985 - 6 grupe; në vitin 1986 - 3 grupe; në vitin 1987 - 5 grupe; dhe, në vitin 1988 - 23 grupe ilegale nga “pozita e nacionalizmit e separatizmit shqiptar”.⁸ “...Nga ato grupe të zbuluara, vinte në dukje dokumenti, në 6 prej tyre ishin përfshi edhe disa eprorë, kadetë të shkollave ushtarake dhe persona jashtë përbërjes së APJ-së, ndërsa grupet tjera përbëheshin nga ushtarë të kombësisë shqiptare...”.⁹

Ndaj të gjithë atyre ushtarëve shqiptarë u mbajtën procese të montuara nga ana e gjyqeve ushtarake, ku numri më i madh i tyre u dënuan me burg të rëndë, me motivacion se paskan “*planifikuar dhe përgatitur aksione më të vrazhda në njësi: vrasje të eprorëve dhe ushtarëve; helmimin e ushqimit dhe të ujit; sabotim dhe diversion; grabitjen e armatimit e të municionit; arratisje grupore nga njësitë së bashku me armatimin; shkuarjen në Kosovë për luftë etj...*”.¹⁰

Të dhënat e mësipërme dëshmojnë qartë për karakterin antishqiptar të APJ-së, e cila erdhi në shprehje veçanërisht pas vitit 1981, ku përveç burgosjeve, kemi një rritje enorme të vrasjeve misterioze të ushtarëve shqiptarë. Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut me qendër në Prishtinë, në raportin e tij të 19 qershorit 1990, e paraqet listën prej 33 ushtarëve shqiptarë, të vrarë në harkun kohor janar 1981 - qershor 1990, të cilën në vazhdim po e paraqesim të plotë:

1. S. A. Gashi (1961). Student. Prishtinë. Ka shërbyer në Vojvodinë, Vërshac. Ka vdekur në Beograd, më 07. 07. 1981, plagosur 25 ditë më parë.
2. B. Xh. Bajraktari (1958). Gjakovë. Ka vdekur në Banjallukë, më 05. 08. 1982.
3. S. Sh. Krasniqi (1958). Buqe (Dragash). Ka vdekur në Novo Mesto (Slloveni), më 16. 09. 1982.

⁷ AS.1589.teh-eno 1469, Vojna Tajna - Poverljivo, Nacionalizam u Jugoslovenskom društvo i njegove refleksije u Jugoslovenskoj Nardnoj Armiji, Beograd, januara 1989 godine.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

4. A. S. Balaj (1954). Korreticë e Epërme (Drenas). U dënua nga Gjykata Ushtarake me 10 vjet burgim. Vdes në qeli më 07. 03. 1982.
5. R. R. Zeka. Metergovc, Podujevë. Ka vdekur në Snj. Kroaci. Është thënë se ka bërë vetëvrasje duke u varur në radiator.
6. H. T. Sezairi (1959), Gostivar.
7. N. A. Muja. Gradicë (Drenas). Ka vdekur në burgun e Mostarit, duke u vetëvrrarë i hedhur nga dritarja.
8. I. Sadiku (1957). Student. Rahovicë (Preshevë). Ka vdekur në Split, më 1982.
9. A. B. Osmanaj (1964). Fshatar. Tubohoc (Istog). KA vdekur në Prokuple (Serbi), më 1983.
10. E. S. Elezi (1964). Student. Shkup. KA vdekur më 04. 06. 1983. Është vetëvrasje me varje, është thënë.
11. Në Sh. Gashi (1942). Kopiliq i Ulët. Vdes në Shetinska Gora, më 10. 06. 1984.
12. A. H. Ferizi (1957). Veteriner. Kodrali (Deçan). Ka vdekur në Baçka Topoliha (Vojvodinë), më 23.08.1984.
13. N. M. Jusufi (1965). Me shkollë të lartë të mbaruar. Haraçinë (Shkup). Ka vdekur në Lubjanë, më 1984, një javë pas hyrjes në ushtri.
14. R. I. Blakaj (1963). Jabllanicë e Vogël (Pejë). Vdes në Viroviticë (Kroaci), më 1985.
15. E. F. Sahiti (1962). Student. Papaz (Ferizaj). Ka vdekur në Valevë (Serbi), më 1985, vetëm 15 ditë para mbarimit të ushtrisë.
16. P. Xh. Gashi (1965). Student. Dobridol (Podujevë). Është gjetur i vrrarë në burgun e Ratinës, pranë Valevës (Serbi), më 07. 08. 1985, 38 ditë para mbarimit të ushtrisë.
17. F. S. Berdynaj (1963). Me universitetin e përfunduar. Radavc (Pejë). Ka vdekur në Viroviticë (Kroaci), më 1985.
18. I. Istrefi (1966). Veleshtë, Strugë (Maqedoni). Vdekur në Petrovaradin (Vojvodinë), më 12. 06. 1986.
19. H. R. Shatri (1958). Dentist. Tomoc (Istog). Vdiq në Sarajevë, më 03. 02. 1986. I martuar, me dy fëmijë.
20. S. D. Shabani (1961). Student. Zaskok (Ferizaj). Pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981. Ka shërbyer në Koprivnicë (Kroaci). Ka vdekur në spitalin e Zagrebit, më 07. 04. 1986.
21. R. A. Jusufi (1960). Kotor (Skënderaj). Ka vdekur në Bohinsko Bello (Slloveni), më 05. 12. 1987.
22. T. Z. Hyseni (1962). Velika Reka (Podujevë). I martuar, me dy fëmijë. Ka vdekur në Ajdovshinë (Slloveni), më 18. 09. 1987. Autoritetet kanë deklaruar se e ka vrrarë veten në tualetin e garnizonit.

23. N. M. Ramadani. Bozofc, Tetovë. Ka vdekur në Strumicë (Maqedoni), më 27. 04. 1987.
24. N. R. Ajgeri (1968). Prizren. Vdes në një spital të Beogradit, në vitin 1988.
25. A. M. Lushtaku (1966). Prekaz i Poshtëm (Skënderaj). Ka vdekur në Kranj (Slloveni), më 28. 06. 1988.
26. N. Xh. Gashi, Orrobordë (Istog). Ka vdekur në Riblicë (Slloveni), më 15. 05. 1988, kur kishte edhe dy muaj ushtri.
27. H. Ismaili (1968). Gërbavc, Medvegjë. Ka vdekur në Titograd, më 08. 07. 1988.
28. E. Sh. Ramadani (1970). Brojë (Skënderaj). Ka vdekur në Kroaci, Viroviticë, më 15. 01. 1989.
29. Xh. A. Berisha (1967). Prishtinë. Ka shërbyer në Sombor. Ka vdekur në një spital të Beogradit, më 12. 12. 1989.
30. V. Xh. Hajrizi (1969). Student. Kuklibeg (Dragash). Ka shërbyer në Trogir. Është gjetur i varur në vitin 1990.
31. J. H. Desku (1970). Siçevë (Klinë). Ka vdekur në Suboticë (Vojvodinë), më 18. 05. 1990. Është thënë se e ka vrarë veten.
32. E. Mormorina (1959). Student. Prizren.
33. E. Hasi. Poroj (Tetovë).¹¹

Mirëpo, kjo listë, siç theksohet në fund të raportit, nuk ishte e plotë, për shkak se në shumicën e rasteve familjet e ushtarëve të vdekur nuk kishin mundur të shtinin në dorë “aktet e vdekjes” së mjekëve, të rrëmbyer nga autoritetet ushtarake.¹² Sipas disa burimeve tjera, numri i përgjithshëm i ushtarëve të vrarë ishte 65 e jo 33 siç thuhet në raportin e KMDLNJ-së. Këtë më së miri mund ta shohim në pasqyrën e mëposhtme, në të cilën ofrohen të dhëna konkrete për ushtarët shqiptarë, të vrarë në APJ në harkun kohor 1981-1990:

¹¹ Hans Peter Rullmann, *Ikje masive*, Tiranë, 1997, Informacion i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut për vdekjen e ushtarëve të nacionalitetit shqiptar për periudhën 1981-1990, gjatë kohës kur ata shërbenin në ushtrinë jugosllave. Përgjithësisht në këtë periudhë njëhej zyrtarisht Kushtetuta e vitit 1974.

¹² Po aty.

**PASQYRË E USHTARËVE SHQIPTARË, TË VRARË NË
ARMATËN JUGOSLLAVE (1981-1990)**

Nr.	Emri	Emri i prindit	Mbiemri	Qyteti	Fshati	Viti i lindjes	Viti i vrasjes
1	Besim	Xhemë	Bajraktari	Deçan	Junik	1958	1981
2	Shaban	Sadik	Prushi	Gjakovë	Zylfaj	1961	1981
3	Qerim	Abdurrahman	Aliu	Kumanovë		1961	1981
4	Halil	Habib	Hajrullahu	Lipjan	Banullë	1959	1981
5	Sami	Ali	Gashi	Prishtinë		1961	1981
6	Rrustem	Bali	Bejta	Skënderaj	Prekaz	1956	1981
7	Asllan	Ukë	Gashi	Suharekë		1959	1981
8	Sami	Shani	Krasniqi	Dragash	Buçe	1956	1982
9	Nazmi	Avdullah	Muja	Drenas	Gradicë	1961	1982
10	Shefqet	Abdyl	Jashari	Drenas	Prekaz	1958	1982
11	Ismet	Muharrem	Bojku	Gjakovë	Kusari	1962	1982
12	Hasan	Telat	Sezairi	Gostivar		1959	1982
13	Halil	Halim	Binaku	Klinë	Gllarevë	1952	1982
14	Latif	Mehmet	Zeqiri	Mitrovicë	Kaçanoll	1959	1982
15	Rasim	Ramadan	Zeka	Podujevë	Metrgovc	1961	1982
16	Yzeir	Rrustem	Sadiku	Preshevë	Rahovicë	1957	1982
17	Musë	Ramadan	Hoxha	Suharekë	Bellanicë	1965	1982
18	Adem	Binak	Osmanaj	Istog	Turbohovc	1963	1983
19	Mustafë	Arif	Pantina	Klinë	Gllarevë	1964	1983
20	Enver	Selman	Elezi	Shkup		1965	1983
21	Murat	Muharrem	Isufi	Shkup	Haraçinë	1965	1983
22	Agron	Haxhi	Ferizi	Deçan	Kodralli	1957	1984
23	Ejup	Fejzë	Sahiti	Ferizaj	Papazi	1961	1984
24	Naser	Shaqir	Gashi	Skënderaj	Kopiliq i Poshtëm	1962	1984
25	Beqir	Aziz	Sahiti	Viti	Stubull	1965	1984
26	Abedin	Selman	Balaj	Drenas	Korreticë	1960	1985
27	Malik	Milazim	Azizi	Gostivar	Koritë	1965	1985
28	Mujë	Rexhep	Maqaj	Lipjan	Cerabreg	1965	1985
29	Shemsi	Sokol	Shala	Lipjan	Rufci Ri	1965	1985
30	Fadil	Selim	Berdynaj	Pejë	Radavc	1963	1985
31	Rexhep	Shaban	Blakaj	Pejë	Jabllanicë	1964	1985
32	Fadil	Xhafer	Gashi	Podujevë	Doberdol	1965	1985
33	Enver		Hasi	Tetovë	Poroj	1965	1985
34	Haki	Rexhep	Shatri	Istog	Tomoc	1958	1986
35	Erdogan	Alajdin	Mormorina	Prizren		1958	1986
36	Inajet	Fuad	Istrefi	Strugë	Veleshtë	1966	1986
37	Sami	Daut	Shabani	Ferizaj	Zaskok	1961	1986
38	Fatmir	Nezir	Kurti	Gjakovë	Smolicë	1966	1987
39	Miftar	Sylë	Tali	Gjakovë	Babaj i Bokës	1965	1987
40	Ramush		Shala	Gjilan	Ponesh	1967	1987
41	Aziz	Sadik	Kelmendi	Lipjan	Karaçicë (banoi në Prizren)	1967	1987

42	Esat	Nysret	Ferati	Mitrovicë	Vërbnicë		1967	1987
43	Tafil	Zahir	Hyseni	Podujevë	Lumbardh (Velikorek)		1962	1987
44	Besim	Hashim	Fazliu	Prishtinë			1967	1987
45	Ibrahim	Isuf	Kastrati	Rahovec	Turjakë		1961	1987
46	Qani	Muharrem	Shabani	Rahovec			1965	1987
47	Raif	Adem	Isufi	Skënderaj	Kotorr		1960	1987
48	Mustafë	Mumin	Ramadani	Tetovë	Bozofc		1967	1987
49	Bedri	Niman	Bajgora	Vushtrri			1959	1987
50	Neshat	Xhafer	Gashi	Istog	Orrobordë		1966	1988
51	Osman	Hajdar	Ismajli	Medvegjë	Gërbavc		1968	1988
52	Naim	Ramadan	Ajgeri	Prizren			1968	1988
53	Afrim	Muhamet	Lushtaku	Skënderaj	Prekaz		1966	1988
54	Qamil	Ramadan	Thaçi	Gjakovë	Demjan		1968	1988
55	Halim	Shaqir	Lita	Klinë			1970	1989
56	Xhavit	Alush	Berisha	Prishtinë	Prugoc		1967	1989
57	Enver	Shaban	Ramadani	Skënderaj	Brojë		1970	1989
58	Izet		Ismajli	Vushtrri	Banjë		1949	1989
59	Vahedin	Xhemshit	Hajrizi	Dragash	Kuklibeg		1969	1989
60	Hamitë	Jahë	Haxhiu	Gjakovë	Batushë		1957	1990
61	Jetullah	Haxhi	Desku	Klinë	Siçevë		1970	1990
62	Halim	Halil	Gashi	Lipjan	Aklap		1969	1990
63	Xhevdet	Hajredin	Aruçi	Skënderaj	Rezallë		1966	1990
64	Fatmir	Adem	Tafaj	Suharekë	Grejkoc		1970	1990
65	Muhamet	Tahir	Osmani	Podujevë	Ballofc		1968	1990 ¹³

Për sa më sipër shihet se numër më të madh të ushtarëve të vrarë kemi gjatë vitit 1987, gjithsej 12 ushtarë, që lidhet drejtpërdrejt me ngjarjen që ndodhi më 3 shtator 1987 në kazermën ushtarake në Paraqin të Serbisë, kur autoritetet ushtarake-policore jugosllave, njoftuan për “*vrasjen e katër ushtarëve jugosllavë dhe pesë të tjerëve të plagosur*”, vepër, gjoja e kryer nga ushtari shqiptar, Azis Kelmendi*, i cili më pas gjoja se “*ka kryer vetëvrasje*”,¹⁴ e në fakt ai qe vrarë nga policia ushtarake.

Kjo ngjarje, e cila ngeli e pazbardhur, sipas të gjitha gjasave, ishte një vepër e inskenuar mirë nga ana e shërbimit sekret ushtarak KOS, aq më tepër kur A. Kelmendit i kishin ngelur vetëm edhe 6 ditë që ta kryente shërbimin ushtarak. Kësaj duhet shtuar edhe faktin se autoritetet ushtarake jugosllave nuk i lejuan familjes së Kelmendit që ta shih arkivolin e birit të tyre. Nuk vonoi shumë, autoritetet e atëhershme lokale të Prizrenit, familjes

¹³ Qazim H. Berisha..., vepër e cituar.

* Aziz Sadik Kelmendi, i lindur në vitin 1967 në f. Karaçicë, komuna e Lipjanit, me banim të përhershëm në Prizren.

¹⁴ AS.1589.teh-eno 1469..., Vojna Tajna - Poverljivo, Nacionalizam u Jugoslovenskom društvo i njegove refleksije u Jugoslovenskoj Narodnoj Armiji, Beograd, januara 1989 godine.

së A. Kelmendit, prindërve, dy vëllezërve dhe motrës, iu kërkua të largoheshin nga Prizreni. Përveç kësaj, ndaj motrës së saj të mitur, filloi procedura për përjashtim nga shkolla.¹⁵

Ndërkohë, mediat e atëhershme jugosllave, në radhë të parë ato serbe, maqedonase e malaziasë, këtë incident e shfrytëzuan për nxitje të atmosferës politike. “*Kelmendi shtiu mbi Jugosllavinë*”,¹⁶ ishte titulli kryesor në gazetën “Politika” të 4 shtatori. Edhe mediet e tjera jugosllave komentuan ngjashëm. Me një tonë edhe më të ashpër ishin deklaratat e udhëheqësve politikë jugosllavë. Anëtarja e Kryesisë së KQ të LKM-së, Lençe Sofronievaska, në referatin e lexuar në mbledhjen XII të KQ LKM-së, i cili u mbajt më 23 shtator 1987, ndër të tjera, shprehet se pas ngjarjes së Paraqinit, udhëheqja politike jugosllave, përkatësisht ajo maqedonase duhet radikalizuar masat represive ndaj popullsisë shqiptare: “...Vrasja e katër ushtarëve të rinj, shprehet Sofronievaska, nga ushtari i ushqyer me ideologji të nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar paraqet aktin armiqësor terrorist të orientuar kah mbarë vendi, ndaj Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe kombeve e kombësive tona mbarë... Kjo flet se ky akt i cili vjen si pasojë dhe shprehje e situatave të përgjithshme të nxitura nga veprimtaria e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar paraqet vërejtjen e skajshme për mbarë shoqërinë tonë, se duhet në mënyrë radikale ta ndërrojmë vetëdijen dhe sjelljen ndaj tërë asaj që e lind dhe e nxit nacionalizmi dhe pasojat e rënda që burojnë nga ai...”.¹⁷

Po në këtë frymë është edhe fjalimi i kryetarit të KQ LKM-së, Jakov Lllazarovskit, i cili situatën politike e të sigurisë në RS të Maqedonisë, e paraqet si tepër “...të ngarkuar me problemin e nacionalizmit e separatizmit shqiptar”. “... Ngjarjet më të reja të ndodhura pas mbledhjes së Nëntë të KQ LKJ-së e deri te sulmi i fundit më i ashpërti dhe më agresivi ndaj integritetit të APJ-së dhe sigurisë së Jugosllavisë, shprehet Lllazarevski, vënë në dukje për eskalimin e mëtutjeshëm të nacionalizmit e separatizmit shqiptar dhe cenimin e marrëdhënieve ndërnacionale në Kosovë e më gjerë... Krejt kjo flet se megjithatë sjellja e përgjithshme e jona nuk korrespondon me

¹⁵ Branko Horvat, *Kosovsko Pitanja*, Globus, Zagreb, 1987, f. 173.

¹⁶ Rade Dragović, *Kelmendiev pucanj u Jugoslaviju*, Novosti, Beograd, 17.09.2017.

¹⁷ ДАРМ.1.427.584.70/166-177, Ленче Софронијева, член на Председателството на Централниот комитет на СКМ, Воведно излагање за идејно-политичката активност на членството, организациите и органите на СКМ во оstarувањето на политиката на СК во развојот на меѓунационалните односи, оstarувањето на Заклучоците од Деветата седница на ЦК СКЈ за реализација на Ставовите на СКЈ во развојот на социјалистичкото самоупраување, братството, единството и заедништвото на Косово и во борбата против албанскиот национализам и сепаратизам и другите национализми, Скопје, 23 септември 1987 година.

*kompleksitetin dhe karakterin e situatës dhe në thelb kjo paraqet arsyen më serioze për stërzgjatjen dhe joefikasitetin e aksionit në luftën kundër nacionalizmit e separatizmit shqiptar... ”.*¹⁸

Fillimi i vitit 1991 ishte i kobshëm për ushtarët shqiptarë, sepse më 1 janar të atij viti erdhi lajmi i hidhur, se në kazermën e Quprisë së Serbisë, jetën e kishte humbur ushtari Izet Bushi, nga fshati Pustenik, komuna e Kaçanikut. Vdekja (vrasja) e tij, sikurse edhe e dhjetëra të tjerëve gjatë vitit 1991, qe misterioze. Dy ushtarakët jugosllavë, të cilët e përcillnin kufomën i informuan anëtarët e familjes Bushi dhe qytetarët se Izeti paska “bërë vetëvrasje” në orët e hershme të mëngjesit, se si gjoja ky “ia paska rrëmbyer pushkën rojës dhe e paska vrrarë veten te parku i automjeteve...”.¹⁹ Varrimi i të ndjerit u krye më 4 janar 1991 në livadhet e Sumrekës të fshatit Pustenik, ku u tubuan mbi 150 000 vetë nga mbarë hapësirat shqiptare. Para masës së tubuar foli nënkryetari i KMDNJ-së, prof. dr. Zekiria Cana, i cili ndër të tjera tha: “... *Sot në janarin e këtij viti u hap edhe një varr... Sot ndodhi ajo që po ndodh që nëntë vjet me radhë... Si mund të quhet ajo Armatë e cila vret bijtë tanë? Kjo që po ngjet, nuk ka ndodhur as në kohën e Perandorisë Osmane, as të kraljëve të ish-Jugosllavisë e tash po ndodh... Kjo armatë nuk është e jona, ku janë motrat dhe nënat jugosllave, a kanë ato fëmijë dhe vëllezër, përse ato nuk po e ngritin zërin e protestës. Pse Evropa nuk po e ngre zërin për tragjedinë që po ngjet me shqiptarët... etj.*”²⁰ Lidhur me “vetëvrasjen” e Izet Bushit, reagoi edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (më tej LDK), Ibrahim Rugova, i cili ndër të tjera kërkoi nga APJ-ja që të japë përgjigje për “pësimet e ushtarëve shqiptarë në armatë”.²¹

Po gjatë atij muaji, u vra edhe një ushtar tjetër shqiptar, Lulzim (Faik) Rexhepi, 23-vjeçar nga Zabeli i Epërm i Drenasit, trupi i të cilit u gjet i vdekur në hekurudhën e Viroviticës (Kroaci) ku shërbente në APJ.²² Lidhur me vrasjen e L. Rexhepit, sekretari i LDK-së, Jusuf Buxhovi, në konferencën për shtyp të mbajtur, më 18 janar 1991 tha: “...*Për fat të keq, të shpeshta janë bërë konferencat tona, në të cilat po mbizotërojnë lajme tragjike. Sikur para dy javësh kur kumtuam, lajmin për vdekjen e ushtarit Izet Bushi nga Kaçaniku edhe sot duhet të komunikojmë lajmin tragjik për vdekjen edhe të një ushtari shqiptar – Lulzim Rexhepit nga Zabeli i Epërm i Gllgovcit, i cili vdiq tragjikisht në Viroviticë, duke qenë në shërbim të APJ-*

¹⁸ ДАРМ.1.427.584.71/178-181, Јаков Лазаревски, Завршен збор на Дванаесетата седница на Централниот комитет на СКМ, Скопје, 23 септември 1987 година.

¹⁹ *Flaka e vëllazërimit*, 4 janar 1991, f. 4.

²⁰ Zëri i protestës kundër vrasjeve misterioze, *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 6 janar 1991, f. 5.

²¹ *Flaka e vëllazërimit*, 6 janar 1991, f. 4.

²² Edhe një viktimë e re, *Flaka e Vëllazërimit*, Shkup, 18 janar 1991, f. 5.

së...”. Duke e komentuar njoftimin zyrtar se gjoja i ndjeri paska bërë “vetëvrasje”, refren i cili përsëritej sa herë që bëhej fjalë për të rinjtë shqiptarë, Buxhovi shprehet: “...Është shumë e çuditshme kjo, kur dihet se shqiptarët edhe përkundër rrethanave tragjike nuk kanë treguar shenja as të depresionit individual e as të atij kolektiv, e tash na del se ata masivisht bëjnë vetëvrasje gjatë shërbimit në APJ...”.²³

Në pjesën e parë të muajit janar, Kryesia e RSFJ-së, solli vendim për shpërbërjen e të gjitha njësive ushtarake të cilat nuk ishin pjesë përbërëse e APJ-së, apo e MPB-së, me ç’rast lëshoi një Urdhëresë, përmbajtja e së cilës ishte:

“1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Urdhërese, në territorin e Jugosllavisë duhet të shpërbëhen të gjitha formacionet e armatosura të cilat nuk janë pjesë e forcave të vetme të armatosura ose të organeve për punë të brendshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe organizimi i të cilave nuk është përcaktuar në pajtueshmëri me ligjet dhe dispozitat federative.

2. Armatimi dhe pajisja e formacioneve të armatosura nga pika 1 e kësaj Urdhërese, t’u dorëzohet menjëherë njësive dhe institucioneve më të afërta të Armatës Popullore të Jugosllavisë, pa marrë parasysh se a është grumbulluar nga organe të caktuara republikane apo gjendet te grupe dhe individë të ndryshëm.

3. Personat, të cilët posedojnë armatim ushtarak, municion apo mjete tjera luftarake, janë të obliguar ta dorëzojnë në njësinë apo institucionin më të afërt të Armatës Popullore të Jugosllavisë.

4. Aktivitetet nga pika 1-3 nga kjo Urdhëresë duhet të përfundojnë në afat prej dhjetë ditëve nga dita e miratimit. Personat, të cilët obligimet e veta të parapara me këtë urdhëresë do t’i kryejnë në afatin e caktuar, nuk mund të jenë të ftuar në përgjegjësi, ndërsa kundër të tjerëve, të cilët nuk do ta plotësojnë këtë obligim, do të zbatohen masa të parapara me ligj.

5. Lidhur me zbatimin e kësaj Urdhërese, sipas vendimit të veçantë të Kryesisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Armata Popullore e Jugosllavisë do të siguroj mbrojtje për të gjithë qytetarët të mbarë territorit, nëse organet tjera kompetente nuk janë në gjendje këtë ta bëjnë.

6. Sekretariati Federativ për Mbrojtje Popullore në kryerjen e shërbimeve dhe punëve inspektuese, të paraparë me ligjin për mbrojtje të përgjithshme popullore, do ta kontrolloj zbatimin e kësaj Urdhërese.

²³ Brengosje për ushtarët shqiptarë në APJ, *Flaka e Vëllazërimit*, Shkup, 20 janar 1991, f. 5.

7. Zbatimin e kësaj Urdhërese do ta sigurojnë njësitë dhe institucionet e Armatës Popullore të Jugosllavisë, të cilat do t'i caktoj Sekretariati Federativ”.²⁴

Menjëherë pas kësaj urdhërese, doli me komunikatë zyrtare, Sekretariati Republikan për Mbrojtje Popullore të Sllovenisë, ku ndër të tjera thuhej se qytetarët e Sllovenisë, nuk kanë nevojë për mbrojtje plotësuese nga ana e APJ-së, për arsye se: *“Mbrojtja territoriale e Republikës së Sllovenisë është një forcë e armatosur legjitime dhe për të nuk vlen Urdhëresa e Kryesisë”*.²⁵ Ndërkohë, me komunikatë doli edhe Këshilli për Mbrojtje Popullore dhe ruajtjen e rregullimit kushtetues të Kroacisë: *“Thirrja për çarmatosjen është e arsyeshme. Mirëpo, Kroacia mundet vetë t'i çarmatos grupet e armatosura në Krahinën e Kninit”*.²⁶

Dy komunikatat e mësipërme, ishin dëshmi e qartë se Sllovenia dhe Kroacia shkonin drejt shpalljes së pavarësisë së tyre dhe njëkohësisht shkëputjes nga federata jugosllave. Për rrjedhojë, ky aksion u zbatua vetëm në trevat shqiptare, përkatësisht në Kosovë dhe në Maqedoninë Veriperëndimore, të cilat nga ana e Komandës III të APJ-së me qendër në Shkup, qenë shpallur si *“zona krize e të pasigurta”*.²⁷ Kryesia e LDK-së, përmes një letre dërguar Kryesisë dhe Këshillit Ekzekutiv të RSFJ-së, shfaqti shqetësimin e saj dhe të mbarë popullit shqiptar në Kosovë që *“aksioni i mbledhjes së armëve të mos merr elemente të një fushate të tmerrshme kundër shqiptarëve, ngjashëm me vitin 1956”*.²⁸ Ndërkohë, në konferencën e rregullt për shtyp të LDK-së, e cila u mbajt më 26 janar 1991 në Prishtinë, nënkryetari, Fehmi Agani, u shpreh: *“...Bisedimet e filluara për fatin e Jugosllavisë u hodhën poshtë me urdhëresën e Kryesisë së RSFJ-së për çarmatimin e formacioneve jashtë ushtarake dhe me kërcënimet e kreut ushtarak jugosllav. Aksioni për çarmatimin, theksoi më tej profesor Agani, paraqet tentim të hapur të presionit për t'u imponuar njëri nga opsionet për rregullimin e Jugosllavisë. Ky aksion ka karakter të kundërt me proklamimet e Kryesisë së RSFJ-së për zgjidhjen demokratike të problemit të rirregullimit të Jugosllavisë...”*.²⁹ Në këto rrethana, vrasjet e ushtarëve shqiptarë tashmë ishte bërë një dukuri e përditshme. Nënkryetari i KMDLNJ-së në Prishtinë, dr. Zekiria Cana, në konferencën për shtyp që e mbajti më 19 janar 1991, gazetarëve të pranishëm ua dorëzoi listën e

²⁴ Митре Арсовски, *Хроника на еден неминовен распад - Сведоштва*, Shkup, 1995, f. 20-21.

²⁵ *Po aty*, f. 23.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Po aty*, f. 39.

²⁸ Flaka e vëllazërimit, 27 janar 1991, f. 4.

²⁹ *Po aty*.

pakompletuar prej 52 ushtarëve shqiptarë të vrarë nga viti 1981 e deri në atë moment.³⁰ Siguria e ushtarëve shqiptarë u përkeqësua edhe më shumë, me shpërthimin e luftës, fillimisht në Slloveni e më pas edhe në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Situata e krijuar e detyroi Lidhjen Demokratike të Kosovës si dhe partitë tjera shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Luginë të Preshevës e në Mal të Zi, që të dalin me apel që të rinjtë shqiptarë “*mos të shërbejnë në APJ*”.³¹

Ndërkohë, pas vrasjes së një ushtarit maqedonas, Sasho Geshoski, që ndodhi më 6 maj 1991 në Split,³² reagime kundër APJ-së u shfaqën edhe nga partitë politike maqedonase, në radhë të parë nga VMRO-DPMNE-ja.³³ Pikërisht me nismën e kësaj partie, Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë thirri mbledhje urgjente me një pikë të rendit të ditës: “Gjendja politike dhe e sigurisë në RS të Maqedonisë dhe në RSF të Jugosllavisë”. Në këtë mbledhje, e cila u mbajt më 9-10 maj 1991, u sollën konkluzione në lidhje me gjendjen e pasigurisë së ushtarëve në APJ, ku në pikën tetë të tyre thuhej shprehimisht:

“Ngarkohet Qeveria e RSM-së që nga Sekretariati Federativ për Mbrojtje Popullore dhe Shtabi i Përgjithshëm i ARM-së të kërkojë verifikimin e fakteve për dërgimin eventual të numrit më të madh të ushtarëve nga Maqedonia për shkak të mungesës së plotësisht të APJ-së nga republikat tjera. Nëse konstatohet se ekzistojnë raste të tilla, të ndërpritet menjëherë me atë praktikë e cila e vë në pikëpyetje karakterin jugosllav të APJ-së dhe të sigurohet përfaqësim proporcional i obliguesve të APJ-së nga të gjitha republikat. Gjithashtu, Qeveria nga Ministria për Mbrojtje Popullore të kërkojë të bëjë verifikimin se a janë të vërteta njohuritë se në njësi të caktuara në APJ, në zonat e krizës, pjesëtarët e APJ-së nga Maqedonia janë përfshi me përqindje më të madhe sesa ushtarët nga republikat tjera...”.³⁴ Pas këtyre konkluzioneve u vërejt qartazi njëanshmëria e udhëheqjes politike maqedonase, kur bëhej fjalë për fatin e ushtarëve në APJ nga kjo republikë. Ndaj këtij qëndrimi të padrejtë, reagoi sekretari i Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD), Mit’hat Emini, i cili në

³⁰ Po aty, 20 janar, 1991, f. 6.

³¹ Po aty, 31 maj 1991, f. 10.

³² Po aty, 8 maj 1991, f. 1,3.

³³ Partia Nacionaliste e Konservative maqedonase e themeluar në pranverë të vitit 1990, e cila në zgjedhjet e para shumëpartiake të organizuara gjatë nëntorit të vitit 1990, doli partia e para me gjithsej 37 deputetë të fituar. <https://www.sobranie.mk>, Историја на парламентаризмот во Македонија.

³⁴ ДАРМ. Ф. Влада на Република Македонија (159) (fondi i pa sistemuar), Заклучоци на Собранието на Социјалистичка Република Македонија Број. 08-1889/1, 24 maj 1991 година, Скопје.

konferencën për shtyp të mbajtur më 16 korrik 1991 në Tetovë, ndër të tjera tha: “...Maqedonia, pas ngjarjeve në Slloveni, nuk tregoi interes të njëjtë ndaj ushtarëve. Vazhdimisht potencohen ushtarët maqedonas, thujtse nga kjo republikë nuk pati edhe ushtarë nga nacionalitetet tjera. Duhet të dihet se këta ushtarë jomaqedonas kanë nënat e tyre dhe janë të nevojshëm për Maqedoninë...”.³⁵

Paraprakisht, me nismën e Forumit të Gruas Shqiptare pranë PPD-së, më 12 korrik të vitit 1991, para Kuvendit të RSM-së u organizua një tubim protestues i grave dhe nënave shqiptare, djemtë e të cilave ishin ushtarë në APJ. “Nuk kemi djem për pazarllëqet e të tjerëve!”, ishte njëra nga porosinë drejtuar organeve republikane të grave shqiptare, nga takimi me udhëheqësit e lartë republikanë. Ato nuk u pranuan nga kryetari i Republikës, Kiri Gligorov, e as nga kryetari i Kuvendit, Stojan Andov, por nga nënkryetari i Kuvendit, Tito Petkovski dhe ministri i Mbrojtjes Popullore, Risto Damjanovski.

Në atë protestë, nënat shqiptare i shtruan gjithsej shtatë kërkesa, të cilat i lexoi Gjylimsere Kasapi, kryetare e Forumit të Gruas Shqiptare pranë PPD-së: “*Të kthehen menjëherë të gjithë ushtarët nga Maqedonia që shërbimin e kryejnë në mbarë territorin e Jugosllavisë; garancë me shkrim nga organet republikane se bijtë e tyre do të kthehen nga zonat e luftës, se nuk do të dënohen dhe keqtrajtohen; derisa nuk zgjidhet çështja shqiptare në Jugosllavi, të gjithë të rinjtë shqiptarë shërbimin ushtarak ta kryejnë në Maqedoni; rekrutimi të bëhet njësoj si për shqiptarët, ashtu edhe për maqedonasit dhe të tjerët, e jo të lejohet që nga e njëjta familje, të rekrutohen nga disa ushtarë shqiptarë; ushtarët shqiptarë të mos kenë trajtim të posaçëm në armatë dhe të mos mbahen dosjet e veçanta që krijohen nga bisedat e ndryshme informative; nënat shqiptare shprehin revoltën e tyre kundër mobilizimit të rezervistëve nga Maqedonia, në mënyrë që ata të mos shfrytëzohen për qëllime të errëta nacional-shoviniste në pjesët tjera të Jugosllavisë, dhe së fundi: gratë dhe nënat shqiptare, ia bëjnë me dije pushtetit se do të lindin dhe do të rrisin djem vetëm për një armatë, e cila do ta siguronte paqen, mirëqenien dhe lirinë që do ta gëzojnë të gjithë njësoj...”.*³⁶ Tri ditë më vonë, përkatësisht më 15 korrik 1991, nën organizimin e Forumit të Gruas së LDK-së, në Prishtinë u mbajt manifestimi i nënave shqiptare nga Kosova, në mbrojtje të djemve të tyre, të cilët pa dëshirën dhe vullnetin e tyre ishin dërguar në frontin e luftës në Slloveni. Pas këtij manifestimi protestues, në të cilin morën pjesë mbi 20

³⁵ Konferencë shtypi e PPD-së, *Flaka e vëllazërimit*, 17. VII. 1991, f. 2.

³⁶ *Flaka e vëllazërimit*, Gratë shqiptare në Kuvendin e Maqedonisë, Shkup, e diel, 14. VII. 1991, f. 5.

mijë nëna shqiptare, Forumi Demokratik i Grave të Kosovës dhe Këshilli i Prindërve të ushtarëve, të cilët gjendeshin në shërbimin ushtarak në APJ, i dërguan një protestë Kryesisë së RSFJ-së dhe Sekretariatit Federativ për Mbrotjen Popullore, në të cilën midis tjerash thuhej: “...*Ne jemi me të gjitha nënat që kërkojnë fëmijët tanë të mos i kthejnë pushkën njëri-tjetrit. Protestojmë dhe kërkojmë që fëmijët tanë të mos keqpërdoren për qëllime të politikës së ditës, kurse jemi të brengosura për fatin e 500 ushtarëve shqiptarë, të cilët në Slloveni presin që organet jugosllave të pushtetit t’u japin garanci me shkrim...*”.³⁷

Po nga ana e këtij forumi, iu dërgua një ftesë nënave sllovene, kroate, boshnjake etj., fëmijët e të cilave ishin ushtarë në Kosovë: “... *Ne, nënat shqiptare, tani 10 vjet po i presim bijtë tanë në arkivolet e blombuara që na kthehen nga armata. Djemve tanë nuk u mbollëm urrejtje që të shtypin e vrasin popujt që duan të jetojnë të lirë. Duke dashur t’u dalim në ndihmë, ju bëjmë ftesë nënave sllovene, kroate, myslimane e tjera liridashëse, bijtë e të cilëve kryejnë shërbimin ushtarak në Kosovë, le të vijnë t’i shohin fëmijët e tyre... Pasi hotelet kosovare janë plotë milicë dhe mund të kenë probleme rreth vendosjes, ne i ftojme në shtëpitë tona të varfra...*”, thuhej ndër të tjera në ftesën e Forumit të Gruas së LDK-së, të nënshkruar nga Flora Brovina.³⁸

Pas ndërprerjes së luftimeve në Slloveni dhe tërheqjes së APJ-së nga ajo ish-republikë jugosllave, zhvillimet luftarake fillimisht u përshkallëzuan në Kroaci e më pas edhe në Bosnjë-Hercegovinë. Njësitë e APJ-së, në bashkëveprim me formacionet e shumta çetnike serbe, pasi pushtuan një pjesë të madhe të territorit të Kroacisë, zbatuan dhunë dhe terror të paparë ndonjëherë ndaj popullsisë civile kroate. Si rrjedhojë e kësaj politike të dhunshme, Bashkimi Evropian, në mbledhjen e jashtëzakonshme e cila u mbajt më 27 gusht 1991 në Bruksel, miratoi Deklaratën për Jugosllavinë, me të cilën BE-ja e konsideronte si të papranueshme ndryshimin me forcë të kufijve, siç pretendonin ta bënin në Kroaci formacionet e parregullta serbe dhe ato të APJ-së: “...*Është tërësisht e gabueshme, theksohej në Deklaratë, politika e formacioneve të parregullta serbe që përpiqen problemet t’i zgjidhin... me mjete ushtarake. Brengosje edhe më e madhe është ajo se tashmë nuk mund të kontestohet se elemente nga APJ i japin mbështetje aktive palës serbe. Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare e ftojnë Kryesinë e RSFJ-së që menjëherë ta ndërpret këtë përdorim jologjitim nga ana e forcave të cilat janë nën komandën e saj. BE-ja dhe shtetet e tij anëtare nuk do ta pranojnë asnjëherë politikën e aktit të kryer. Ata janë të*

³⁷ Flaka e vëllazërimit, 17. VII. 1991, f. 4.

³⁸ Kosova e këtyre ditëve, kronikë ngjarjesh, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 19. VII. 1991, f. 4.

*vendosur të mos e pranojnë ndryshimin e kufijve me forcë dhe do t'i nxisin edhe të tjerët ta bëjnë të njëjtën... ”.*³⁹

Për fatin tonë të keq në këto luftime kroato-serbe u viktimizuan shumë ushtarë shqiptarë. Gazeta në gjuhën shqipe “Flaka e vëllazërimit”, thujse në çdo numër të saj njoftonte për një, dy apo më shumë ushtarë shqiptarë të rënë në vatrat e luftës në Kroaci.⁴⁰ Pikërisht vrasjet e pakontrolluara të ushtarëve shqiptarë qenë shkas që një delegacion i Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut të qëndrojë për disa ditë në Kosovë dhe në Maqedoni. Delegacioni vizitoi një numër të madh të familjeve të ushtarëve të vvarë, me ç’rast, për të satën herë konstatoi për shkallën alarmante të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të shqiptarëve.⁴¹

Me kërkesë të prindërve të ushtarëve nga Maqedonia të cilët gjendeshin në APJ, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, më 22 dhe 23 gusht 1991, mbajti mbledhje të jashtëzakonshme, me ç’rast miratoi disa konkluzione, me të cilat ngarkohej Qeveria e Republikës së Maqedonisë “që të ndërmerr masa për kthimin e ushtarëve nga APJ-ja”, të cilëve u kishte përfunduar afati ushtarak. Konkluzionet e obligonin edhe anëtarin e Kryesisë së RSFJ-së nga Republika e Maqedonisë, Vasil Tupurkovskin “që të angazhohet në Kryesi për kthimin e ushtarëve nga APJ-ja...”.⁴² Për fatin e ushtarëve nga Maqedonia, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë debatoi edhe në mbledhjen e vet XXIII, punimet e së cilës u zhvilluan më 17 shtator 1991, në të cilën u miratuan mendimet dhe qëndrimet e Këshillit për çështje të mbrojtjes popullore, ku thuhej tekstualisht: *“Rekrutët nga Republika e Maqedonisë të mos dërgohen në APJ derisa nuk ndërpriten luftimet në Jugosllavi, ushtarët nga republika të cilët janë zhvendosur në pjesë tjera të Jugosllavisë, shërbimin ushtarak ta kryejnë në Maqedoni, obliguesit ushtarakë rezervë nga republika deri në ndërprerjen e veprimeve luftarake në Jugosllavi të mos ftohen në stërvitje dhe në aktivitete tjera ushtarake ”.*⁴³

³⁹ ДАРМ.1.159, (Fondi i pasisteluar), Влада на Република Македонија, 2.09.1991, Декларација за Југославија (Вонреден министерски состанок на ЕПС-Брисел, 27 август 1991 година).

⁴⁰ *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 4 tetor, f. 3; *Po aty*, 6 tetor, f. 3, etj.

⁴¹ *Po aty*, 3 nëntor 1991, f. 4.

⁴² ДАРМ.1.159, Република Македонија - Собрание на Република Македонија, Број 41-4140/90-XXI, 26 август 1991 година, Скопје, Заклучоци.

⁴³ ДАРМ.1.159, Влада на Република Македонија, 30.IX.1991, единица 41, број 3940/1, Иницијатива за донесување одлука за заштита на војниците и старешините граѓани на Република Македонија, кои се заробени ја напуштиле или пребегнале од Југословенската народна армија.

Ndërkohë, Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë, në informatën e 3 tetorit 1991, vlerësonte se kërcënimet kryesore për stabilitetin e gjendjes së sigurisë, sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të asaj republike, si dhe për paqen, sigurinë personale e pronësore të qytetarëve burojnë nga aktiviteti i APJ-së. Informata e MPB-së, theksonte: “...Ngjarjet e fundit në vend, si dhe sjelljet e APJ-së në përlëshjet e armatosura në Kroaci dhe BeH, në mënyrë të qartë nxjerrin në pah se APJ në mënyrë të hapur po legjitimohet si eksponent i politikës hegjemoniste serbomadhe për krijimin e të ashtuquajturës ‘Serbi të Madhe’, ndërsa udhëheqja e saj e shtrembëron pozitën kushtetuese e armatës dhe vepron jashtë kontrollit të pushtetit të tij...”⁴⁴ Nisur nga kjo, MPJ i propozonte Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që me procedurë të përsheptuar të përgatiten dhe të miratohen të gjitha aktet dhe nënaktet ligjore që i përkasin aspektit ushtarak e të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, si dhe ato për “formimin e forcave të armatosura... etj.”⁴⁵

Përderisa fati i ushtarëve shqiptarë, banorë të Republikës së Maqedonisë, deri diku pati një zgjidhje fatlume, kjo çështje ngeli edhe më tej e hapur për ushtarët shqiptarë të Kosovës, Luginës së Preshevës dhe Malit të Zi. Droja për fatin e tyre u shtua edhe më shumë në momentin kur policia ushtarake kreu arrestimin e dy grupeve të ushtarëve shqiptarë (grupi i parë prej 30 vetash në Sarajevë dhe grupi i dytë prej 130 vetash në aeroportin e Shkupit). Menjëherë pas këtyre dy rasteve, një delegacion i Kosovës në përbërje të Skënder Skënderit, Ali Aliut dhe Isak Ramadanit, arriti marrëveshje me Qeverinë e Sllovenisë për strehimin e ushtarëve shqiptarë në Slloveni. Për rrjedhojë u formua Këshilli për Strehim, me ç’rast Qeveria sllovene mori përsipër sigurimin e objektit, ndërsa pala shqiptare ushqimin dhe veshmbathjen.⁴⁶ Ndërkohë, Anton Kola, në konferencën e rregullt për shtyp të LDK-së, e cila u mbajt më 25 tetor 1991, duke u ndalë në luftimet që po zhvilloheshin në Kroaci dhe Bosnjë- Hercegovinë, tha: “...duam t’u themi gjeneralëve jugosllavë se Kosova nuk dëshiron të mbetet në njëfarë mini Jugosllavi dhe se për ne është i huaj dhe i papranueshëm mobilizimi i ushtarëve dhe rezervistëve shqiptarë në Armatën jugosllave...”⁴⁷ Kah mesi i dhjetorit të vitit 1991, senatori i SHBA-së, Robert Dol, i dërgoi një letër të dërguarit të OKB-së në Jugosllavi, Sajrus Vens, përmes së cilës ai ia bën me dije se “është shumë e arsyeshme” që në

⁴⁴ ДАРМ.1.159, Министерство за внатрешни работи на Република Македонија, Строго Поверливо, Информација за актуелната безбедносна состојба во Република Македонија, Евид. Бр. 272, Скопје, 03.10.1991 година.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Flaka e vëllazërimit, 11 tetor 1991, f. 4.

⁴⁷ Po aty, 27 tetor 1991, f. 4.

Kosovë të dërgohen forcat paqësore, pasi sipas tij, ekzistonte mundësia reale që konflikti të shpërthente edhe në Kosovën e okupuar.⁴⁸ Po në këtë periudhë kohore, një delegacion i Forumit të Gruas pranë LDK-së zhvilloi takime në disa vende të Evropës Perëndimore, me ç’rast delegacioni bëri përpjekje për ndërkombëtarizimin e çështjes së ushtarëve të ikur shqiptarë nga fronti i luftës serbo-kroate...”⁴⁹

Në përmbyllje të këtij punimi po e paraqesim listën prej 59 ushtarëve shqiptarë, të vrarë në harkun kohor 1991-1993, ku siç do të shohim, 54 prej tyre u vranë gjatë vitit 1991, dy gjatë vitit 1992 dhe 3 gjatë vitit 1993.

Pasqyrë e ushtarëve shqiptarë, të vrarë në Armatën jugosllave (1991-1993)

Nr.	Emri	Emri i prindit	Mbiemri	Qyteti	Fshati	Viti i lindjes	Viti i vrasjes
1	Xhevdet		Pomak	Dragash	Brod	1970	1991
2	Agim	Salih	Gllareva	Drenas	Vërboc	1971	1991
3	Lulzim	Faik	Rexhepi	Drenas	Zabel i Epërm	1969	1991
4	Tahir	Azem	Gashi	Drenas	Vërboc	1971	1991
5	Ali	Nazif	Sahiti	Ferizaj	Komogllavë	1971	1991
6	Muharrem	Faik	Muharremi	Ferizaj	Fshati i Vjetër	1971	1991
7	Sherif	Islam	Kashtanjeva	Ferizaj	Nerodime	1970	1991
8	Abedin	Sabit	Krasniqi	Fushë Kosovë	Bardh i Madh	1970	1991
9	Ejup	Esat	Gashi	Fushë Kosovë	Bardh i Madh	1970	1991
10	Setar	Mustafë	Ramadani	Gjakovë	Osek Hilë	1971	1991
11	Vesel	Dan	Duraku	Gjakovë	Demjan	1972	1991
12	Fadil	Xhabir	Saliu	Gjilan	Livoq	1971	1991
13	Elez	Bajram	Hasipi	Gostivar	Vrapçishtë	1970	1991
14	Taip		Aliu	Gostivar	Forinë	1972	1991
15	Abedun	Ali	Buleshkaj	Istog	Buleshkaj	1969	1991
16	Enver	Salih	Maksutaj	Istog	Orrebërdë	1970	1991
17	Selman	Shpend	Metaj	Istog	Shushicë	1971	1991
18	Izet	Sadri	Bushi	Kaçanik	Pustenik	1971	1991
19	Florim	Adem	Kosumi	Kamenicë	Tuxhec	1971	1991
20	Muhamed	Raif	Biçku	Kamenicë	Hogosht	1971	1991
21	Muharrem	Mehmet	Robelli	Kamenicë	Laqiç	1971	1991
22	Mursel	Kasum	Xhambazi	Kërçovë	Cërvicë	1971	1991
23	Haki	Dinë	Morina	Klinë	Gllarevë	1970	1991
24	Nexhmedin		Osmani	Kosovë		1971	1991
25	Afrim		Zylfu	Kumanovë		1970	1991
26	Ejup	Sabri	Berdolli	Lipjan	Çallapek	1971	1991
27	Samedin	Fazli	Krasniqi	Malishevë	Tërpezë	1963	1991

⁴⁸ Po aty, 18.XII.1991, f. 4.

⁴⁹ Po aty.

28	Raif	Jetullah	Miftari	Medvegjë	Kapit	1962	1991
29	Shaban	Bajram	Bajrami	Medvegjë	Kapit	1968	1991
30	Burim	Sherif	Behrami	Mitrovicë		1972	1991
31	Rasim	Ragip	Istrefi	Mitrovicë	Kovaçicë	1963	1991
32	Xhevdet	Zeqir	Muzliukaj	Mitrovicë	Shipol	1971	1991
33	Mirsad		Çekiq	Pejë		1970	1991
34	Afrim	Bahtir	Hyseni	Podujevë	Lumbardh (Velikorekë)	1970	1991
35	Rexhep	Zijadin	Ahmeti	Podujevë	Dobratin	1972	1991
36	Shaip	Salih	Behrami	Podujevë	Pakashticë	1971	1991
37	Fatmir	Nezir	Krasniqi	Prishtinë		1967	1991
38	Shukri	Habib	Kelani	Prishtinë		1971	1991
39	Skender	Demë	Kryeziu	Prizren	Capar	1969	1991
40	Xhiman		Alia	Prizren	Skrobishtë	1971	1991
41	Bashkim	Selim	Krasniqi	Rahovec	Qifilak	1972	1991
42	Elmi	Sejdi	Popaj	Rahovec	Bellacërk	1971	1991
43	Vesel	Muhamed	Gashi	Suharekë	Studentqan	1970	1991
44	Ilaz		Fazliu	Tetovë	Pallaticë	1970	1991
45	Numan		Rexhepi	Tetovë	Lisec	1971	1991
46	Selajdin		Rizvani	Tetovë	Reçicë	1971	1991
47	Fahrush	Emrush	Emini	Viti	Zhiti	1971	1991
48	Mumin	Hafiz	Shkodra	Viti	Sadovinë e Çerkezve	1970	1991
49	Samet	Eset	Bogijevci	Viti	Pozharan	1967	1991
50	Bedri		Elezi	Tetovë	Dobrosht	1969	1991
51	Zadin		Sabiti	Shkup	Llaskarcë	1968	1991
52	Ferat		Beqiri	Tetovë	Zhelinë		1991
53	Nexhedin		Osmani	Shkup	Sullare e Poshtme	1971	1991
54	Nusret	Ruzhdi	Kamberi	Shkup	Studenican	1971	1991
55	Ali	Sinan	Rrustemi	Vushtrri	Reznik	1972	1992
56	Gëzim	Sefer	Hasani	Vushtrri	Strofc	1971	1992
57	Isuf	Ajet	Krasniqi	Drenas	Gllobar	1965	1993
58	Sefer	Bislim	Çukovci	Ferizaj	Cërnillë	1976	1993
59	Enver	Ali	Aliaj	Suharekë	Sallagrazdë	1969	1993 ⁵⁰

⁵⁰ Flaka e vëllazërimit, janar-dhjetor 1991, Shkup.